

VENDIM
Nr. 19, datë 11.2.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HECET “VERBA 1” DHE
“VERBA 2” TË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SHPK SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “II”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9, pikat 1 dhe 2 germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et “Verba 1” dhe “Verba 2”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 4 germat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et “Verba 1” dhe “Verba 2” të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., si burime të rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani